REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.Nr: 01-557/2
Data/Datum/Date: 20/05/2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -2-
PRISHTINË/A (2025)

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministarke Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 93/2026
Datë: 20.05.2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 10 dhe 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me 22 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 2) dhe nenin 25 të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin nr. 08/L-272, në mbështetje të nenit 44 dhe 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) – Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë në detyrë, nxjerr këtë:

V E N D I M
Për pushimin e shërbimit të noterit

1. Znj. Merita (Ajet) Selimi, e emëruar noter në territorin e Komunës së Suharekës, me Vendimin nr. 220/2024, të datës 15.07.2024, i pushon ushtrimi i detyrës së noterit për shkak të dorëheqjes.

2. Shfuqizohet Vendimi nr. 220/2024, të datës 15.07.2024 për emërimin e znj. Merita Selimi në detyrën e noterit dhe Vendimi nr. 94/2025 i datës 26.03.2025 për fillimin e ushtrimit të detyrës së noterit.

3. Obligohet Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën 22.05.2026.

A r s y e t i m

Me Vendimin Nr. 220/2024, të datës 15.07.2024, znj. Merita Selimi është emëruar në detyrën e noterit për territorin e Komunës së Suharekës, ndërsa me Vendimin nr. 94/2025 të datës 26.03.2025 znj. Selimi është caktuar të filloj të ushtroj detyrën e noterit me datën 07.04.2025.

Më datë 19.05.2026, znj. Selimi, përmes një shkrese zyrtare drejtuar Ministres së Drejtësisë, ka paraqitur dorëheqjen nga ushtrimi i detyrës së noterit, duke theksuar se arsyeja e dorëheqjes është personale me efekt nga data 22.05.2026.

Andaj me që dorëheqja e saj është paraqitur në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, në pajtim me neni 22 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe paragrafi 2) dhe nenit 25 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin nr. 08/L-272, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla-Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë

Vendimi i'u dërgohet:

- *Znj. Merita Selimi;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;*
- *Gjykatës Themelore në Suharekë;*
- *Odes së Noterëve të Kosovës;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit te Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika.*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*